

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

PËR T'U BASHKUAR PLATFORMËS SË KONSULTIMIT PËR AGJENDËN E REFORMAVE NË SHQIPËRI

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), pjesë e projektit rajonal [WB Reform and Growth Monitor](#) që zbatohet nga [Think for Europe Network \(TEN\)](#) fton të gjithë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve), dhomave të tregtisë, akademisë, partnerët socialë dhe aktorët e tjerë shoqërorë të shprehin interesin e tyre për t'u bërë pjesë e Platformës të Konsultimit për Agjendën e Reformave në Shqipëri (N-CoMER).

ÇFARË ËSHTË N-COMER?

N-CoMER është konceptuar si një platformë kombëtare e qëndrueshme për dialog dhe bashkëpunim midis aktorëve shoqërorë, institucioneve kombëtare dhe palëve të tjera që janë të përfshirë në hartimin e reformave në Shqipëri. N-CoMER do të veprojë si një hapësirë për konsultime, qendër informacioni, një mjet për advokim të përbashkët dhe një vend për ngritjen e kapaciteteve.

KUSH MUND TË BËHET PJESË?

N-CoMER është e hapur për të gjithë aktorët jo-shtetërorë me përvojë ose interes në Planin e Rritjes, Agjendën e Reformave dhe integrimin evropian. Këtu përfshihen OShC-të, academia, dhomat e tregtisë, partnerët socialë dhe palët e tjera të interesuara. Anëtarët pritet të angazhohen në mënyrë konstruktive duke respektuar parimet e dialogut gjithëpërfshirës, transparent dhe të bazuar në fakte.

PËRSE TË BËHENI PJESË E N-COMER?

N-CoMER ofron një hapësirë konstruktive për bashkëpunim me institucionet përgjegjëse duke ju mundësuar anëtarëve të kontribuojnë në diskutime për monitorimin e reformave dhe ndikuar në zbatimin e Planit të Rritjes në nivel kombëtar. Konkretisht do të:

- Mundësojë konsultime të bazuara në gjetje dhe mekanizma monitorimi;
- Nxisë bashkëpunimin ndërsektorial dhe me nivelet e ndryshme të qeverisjes;

- Ofrojë mundësi për ngritje kapacitetesh dhe mbështetje për advokim;
- Promovojë transparencën dhe llogaridhënien nëpërmjet publikimit të raporteve dhe komenteve të marra nga palët e interesit.

SI MUND TË BËHENI PJESË?

Nëse institucioni që përfaqësoni dëshiron të bëhet pjesë e N-CoMER, ju lutem plotësoni pyetësonin në këtë [link](#) para datës **16.5.2025**.

NË VIJIM

Pas përfundimit të procesit të aplikimit, IDM do të organizojë mbledhjen e parë të N-CoMER. Takimet do të mbahen dy herë në vit në format hibrid me angazhimin e anëtarëve nëpërmjet sesioneve konsultative, aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve dhe mundësive për grante të vogla në kuadër të projektit.

Për më shumë detaje rreth projektit, ju lutem vizitoni faqen zyrtare: <http://reform-monitor.org/>.